



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Nr. 3489/114 Prot.

Pogradec, më 29.09. 2025

VENDIM

NR. 83, DATË 25.09.2025

**MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 28.08.2025 TË
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC**

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 28.08.2025, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 28.08.2025 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARË E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

1.Miratuar me 19 vota

2.Vota Pro 19

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 25.09.2025



Hbledhja date 28.08.2025

	Emri	Atesia	Mbiemri	Subjekti	Prezenca
1	Frederik	Mico	Pikuli	BF	H
2	Marjeta	Feim	Biba	BF	M
3	Ervin	Shpetim	Mancellari	BF	H
4	Albana	Vladimir	Prifti	BF	V
5	Klajdi	Albert	Gjona	BF	FLA
6	Manjola	Petraç	Kamolli	PSSH	H
7	Odhise	Refik	Mihallari	PSSH	V
8	Brunilda	Merdan	Gora	PSSH	BF
	Sara	Agim	Olldashi	PSSH	BF
10	Klea	Edmond	Topa	PSSH	BF
11	Ylli	Xhelal	Kasmollari	PSSH	BF M
12	Silvana	Nikollaq	Bozda	PSSH	BF
13	Besnik	Bedri	Xhyra	PSSH	BF M
14	Mimoza	Feti	Shuli	PSSH	H
15	Jovan	Filip	Shkembi	PSSH	V
16	Anila	Mihallaq	Gjoshe	PSSH	BF
17	Ahmed	Perparim	Guxholli	PSSH	BF
18	Miranda	Fidari	Olldashi	PSSH	BF
19	Mentor	Idriz	Rama	PSSH	BF
20	Elsona	Sotiraq	Turshinka	PSSH	BF V
21	Celnik	Rushit	Haxhillari	PSSH	BF V
22	Vjollca	Tefik	Pllaha	PSSH	BF V
23	Genci	Hamdi	Zyferi	PSSH	BF V
24	Kejvi	Musa	Abrashi	PSSH	V
25	Diogjen	Zarif	Qeva	PAA	V
26	Zhaneta	Arif	Elezaj	PAA	V
27	Engjell	Fluturak	Shyti	PD	V
28	Alketa	Kujtim	Beka	PD	M
29	Arber	Myzafer	Male	LZHK	BF
30	Liri	Neki	Seitllari	LZHK	M
31	Suferin	Axhi	Dokollari	FRD	H

Prezent 21 Keshifellare

[Signature]

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 28.08.2025

ORA : 12:00

JANË PREZENT 21 KËSHILLTARË

PROTOKOLLI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC
DATE 28_.08.2025 , ME KËTË REND DITE.

RENDI I DITËS

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. **Projekt – Vendim :** Miratimi i Procesverbalit të datës 28.07.2025.
4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 28.07.2025.
5. **Projekt – Vendim :** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Korrik 2025.
6. **Projekt – Vendim :** Miratimin e rinovimit të kontratave të qirasë për ambiente arsimore në Bashkinë Pogradec për vitin shkollor 2025-2026.
7. **Projekt – Vendim :** Për akordimin e ndihmës financiare z.Lavdimir Biba, fshati Buzaisht, Nj.A Velcan, Bashkia Pogradec, për humbjen e jetës si pasojë e rënies së rrufesë.
8. **Projekt – Vendim :** Miratimin e projekt marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt I kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, akademisë së trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë.
9. **Projekt – Vendim :** Për miratimin e planit vendor të veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030, të Bashkisë Pogradec.
10. **Projekt – Vendim:** Miratimin në parim të dhënies me qira, në favor të individëve kërkues për ndërtim fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj), të pasurisë me sipërfaqe totale 303259 m2 (treqind e tremijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntëmijë) m2.



11. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 35.5200 ha, të ndodhura në Njësinë Administrative Cërravë që mund të jepen me qera.
12. Raportim nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në lidhje me hapësirat publike.
13. Raportim nga Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike në lidhje me masat e marra dhe punën e kryer për fillimin e vitit të ri arsimor 2025-2026 në arsimin parauniversitar.
14. Të tjera.



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 28.08. 2025

1. “ Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015”.

Diskutime

Miranda Olldashi (Nënkryetare e Këshillit) Përshendetje , në mungesë të znj.Manjola Kamolli , kryetare e Këshillit mbledhjen e muajit Gusht do e drejtoj unë në cilësinë e nënkryetares.

Materialet janë dërguar në mënyre elektronike dhe ne hard copy. Kemi një projekt-vendim shtesë I cili ka kaluar në konsultim publik dhe vjen për tu trajtuar.

Pa humbur kohë po lexoj Rendin e dites. Nqs nuk ka dikush për të thënë dicka e hedhim në votim me ndryshime.

U votua

Pro 19

Kundër 1

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25_. 06. 2025

2. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.

Diskutime

M.Oldashi : Deklarimi I konfliktit të interest është një proces rutinë që bëhet në fillimin e cdo mbledhje. Nqs dikush ka konflikt interesi duhet ta deklaroje .

Nuk ka asnjë këshilltar që të ketë konflikt interesi.

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'J. B.', located in the bottom right corner of the page.

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 28_.08.2025

3. “ Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 28.07.2025 të Këshillit Bashkiak Pogradec”.

Diskutime

M. Olldashi : Procesverbali I mbledhjes së datës 28.07.2025 është dërguar , nqs dikush nuk ka dicka për të diskutuar e hedhim në votim

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më _____.____. 2025

4.Pika : Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 28.07.2025.

Diskutime

Vendimet e mbledhjes së datës 28.07.2025 janë konfirmuar të gjitha.

A handwritten signature in black ink, located in the bottom right corner of the page. The signature is stylized and appears to be a personal name.

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 28.08.2025

5.Pika . Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Korrik 2025.

Diskutime :

M.Olldashi: Ky është një projekt-vendim rutinë që miratohet cdo muaj. Po ja jap fjalën drejtorëshës për ta sqaruar me pak fjalë projekt-vendimin.

I.Llakmani: Për muajin Korrik janë trajtuar me ndihmë ekonomike nga fondi 6% 167 familje me fond 711485 lekë.

M.Olldashi : Nqs nuk ka dikush tjetër dicka për të thënë e hedhim në votim

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet **Po** **JO**



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 28.08.2025

6. Miratimin e rinovimit të kontratave të qirasë për ambiente arsimore në Bashkinë Pogradec për vitin shkollor 2025-2026

Diskutime

M.Olldashi: Rinovimi i kontratave të qirasë për ambiente arsimore është një projekt-vendim që miratohet cdo vit .

Albana Beberi: Këtë vit kemi 3 ambiente që do të merren me qira për të shërbyer si kopështe ose shkolla, përkatësisht në fshatin Selcë e Poshtme , Buzaishtë, Stropckë.Vlerat e Kontratave dhe Kushtet e tyre mbeten të pandryshuara me vitin e kaluar.

M. Olldashi: E hedhim në votim

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet **Po** **Jo**



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 28.08. 2025

7. Për akordimin e ndihmës financiare z.Lavdimir Biba, fshati Buzaisht, Nj.A Velcan, Bashkia Pogradec, për humbjen e jetës si pasojë e rënies së rrufesë.

Diskutime

M. Olldashi: Është një fatkeqësi që ka ndodhur në familjen Biba të cilën fale fondit të emergjencave kemi mundësi ta ndihmojmë.

M.Biba: Unë kam të njëjtën pyetje si në komisione , a kemi mundësi për më shumë?

M.Olldashi: Është e përcaktuar në ligjin e emergjencave vlera që jepet në raste të tilla.

E hedhim në votim projekt-vendimin.

U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po JO



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 28.08. 2025

8: Miratimin e projekt-marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt I kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, akademia e trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë.

M.Olldashi: Është një projekt-vendim që është hartuar nga drejtoria juridike, qëllimi i të cilit është krijimi i personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta në formën e organizatës jofitimprurëse me anëtarësi, midis njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të vetëqeverisjes vendore. Nqs nuk ka dikush dicka për të thënë e hedhim në votim.

U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



9. Për miratimin e planit vendor të veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030, të Bashkisë Pogradec

Diskutime

M. Olldashi: Plani I Barazisë Gjinore kaloi në konsultim public, I cili u zhvillua në sallën e Këshillit Bashkiak. Fjalën I japim drejtoreshës Znj.Ivana Llakmani për të shpjeguar shkurtimisht:

I.Llakmani: Plani I Veprimit për Barazinë Gjinore është udhërrëfyesi ynë për të ndërtuar një Pogradec ku gratë dhe burrat , vajzat dhe djemtë, kanë mundësi të barabarta në cdo fushë të jetës. Ky nuk është thjesht një dokument , por vullneti jonë politik për ta bërë barazinë gjinore një realitet të prekshëm për të gjithë. Plani është hartuar nga Bashkia Pogradec në përputhje me Strategjinë Kombëtare dhe kartën Europiane për barazi. Është një punë e përbashkët me mbështetjen e UN Women dhe Bashkimit European.

Vizioni ynë I përbashkët është një Pogradec ku të gjithë qytetarët , pavarësisht moshës, vendbanimit aftësive apo cdo karakteristike tjetër , gëzojnë respektojnë, dhe kontribuojnë për barazi gjinore reale në cdo aspekt të jetës.

M.Olldashi: E hedhim në votim

U votua

Pro 21 vota

Kundër 0 vota

Abstenim 0 vota

Miratohet Po Jo



10. Miratimin në parim të dhënies me qira, në favor të individëve kërkues për ndërtim fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj), të pasurisë me sipërfaqe totale 303259 m² (treqind e tremijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntëmijë) m².

Diskutime:

M.Oldashi: Është një diskutim për dy projekt-vendime sepse janë për të njëjtin qëllim. Po I jap fjalën kryetarit të komisionit të ekonomisë z. Celnik Haxhillari.

C.Haxhillari: Lidhur me projekt- vendimet që kanë të bëjnë me ndërtimin e fotovoltaikeve mendoj se duhet të kemi parasysh

-Bazën ligjore dhe pronësinë. Kush është pronar I sipërfaqeve që mund të jepen me qera.

-Interesat e komunitetit për këtë pronë që do të jepet me qera.

-Interesi financiar I Bashkisë në rastin konkret për këtë tokë që do të jepet me qera.

- Interesi kombëtar për një projekt të investimit në energjinë e rinovueshme në shkallë vendi.

Duke marrë në konsideratë pikat që përmenda më lart Bashkia ka dalë në konkluzion se mënyra më e mirë për të përdorur këtë sipërfaqe është duke investuar në energjinë e rinovueshme. Përsa I përket kullotave në zonë ka hapësira të tjera që mund të përdoren për kullotjen e bagëtive. Unë mendoj që banorët të sqarohen në lidhje me pretendimet që kanë për dhënien e tokave me qera dhe këto projekt-vendime të shtyhen për mbledhjen tjetër.

E. Shyti: Mqs është tema për dhënien e tokës me qera. Atje bëhet fjalë për një tokë dierë. Ne japim në marim tokën me qera për të rritur të ardhurat e Bashkisë. Ne e



japim në parim nuk e përcaktojmë kush do e marrë. Kërkesën mund ta marrin dhe vetë banorët.

A. Male: Unë doja ta filloja nga roli i konsultimeve publike. Konsultimi public ka si synim të përfshijë banorët në vendimarrjen e Këshillit. Nga konsultimi public që kemi realizuar në fshatin Cërravë ka treguar që interesi i banorëve është që këto sipërfaqe ti përdorin si kullotë. Në konsultimin public nuk kishte specialist të bujqësisë. Në mbledhjen e komisioneve u arsyetua por ai diskutim dhe saqrim duhej bërë ditën e konsultimit.

D. Babasuli(Sekretar i Përgjithshëm): Po ta fillojmë historinë para dy vitesh zona në fjalë është kërkuar nga investitore strategjike e cila u refuzua nga Bashkia.

Investimi që bëhet fjalë tani kërkohet për një projekt të madh i cili sjell zhvillim në zonë dhe jo vetëm. Ne e kemi detyrim ligjor nga ministria për zonat jopjellore për tja ofruar investorëve strategjike e cila është dhe detyrim nga ana jonë për të investuar. Për të dyja parcelat që bëhet fjalë unë kam për detyrë të shpjegoj propozimin e Bashkisë. Këto sipërfaqe kanë 35 vjet që nuk janë shfrytëzuar , kjo është çështje shfrytëzimi dhe administrimi. Përvec kësaj ndërtimi i parqeve fotovoltaike do t thotë dhe punësim .Këto janë arsyet që na kanë shtyre ne për të sjelle këto dy projekt-vendime. Unë nuk jam specialist bujqësie por nga regjistrimet e kullotave Cërava zotëron me pak se 2000 krere , pra kullotat që ka Cërava mbulohen me 40 ha ndërkohë ka rreth 170 ha në të gjithë Cërravën .Këto janë arsyetimet për administratën e Bashkisë tani po ja u lë rradhën ju.

A.Prifti: Unë bashkangjitem me mendimin e Arbërit duke ju referuar ligjit, banorët kanë shumë të drejtë plus ligji nuk e parashikon që kur ka ankesa nga banorët të miratohet projekt-vendimi. Banorët kanë shumë të drejtë .

K.Topa: Ligji nuk e thotë në asnjë moment këtë.

A.Prifti: Përsa i përket arsyetimit të Engjëllit pse nuk e marrin banorët , dua të them që ata tani u vunë në dijeni në lidhje me këtë gjë. Kur ata ta shprehin të gjithë interesin e tyre ne do i mbështesin

D.Babasuli: Me çfarë bazë po e përdorin banorët kur unë nuk kam asnjë dokument që ata të paguajnë një taksë në shtet, ose një kontratë huapërdorje.



K.Topa: Ligji për konsultimin public nuk thotë në asnjë moment që nqs banorët nuk janë dakort ,projekt-vendimin nuk miratohet. Ligji duhet të interpretohet jo vetëm të lexohet. Me shumë kënaqësi do degjojmë dhe banorët.

D.Qeva: Në Cërravë ka kohë që vijnë investitorë dhe marrin tokat me qera, ngushto këtej, ngushto andej. Ky popull do të jetoje dhe duhet të stimulohet për të vazhduar blegtorinë. Punësim nuk l ofrojmë dot si Bashki dhe atë që po e bëjnë vetë për të nxjerë bukën e gojës po ja marrim. Luadhin e Celos e mori ai Tiranesi , Tiranësi prap pjesën e Grabovicës. Duhe të mendohemi 14ire para se ta ngremë kartonin.

Gentian Serianaj(Avokat): Jam avokat që jam marë në telefon për ti përfaqësuar në këtë vendimarrje që ju do të merni nga e cila varet jeta e tyre. Për ti kthyer një përgjigje të shpejtë sekretarit të Bashkisë dua të them që për momentin atje kullosin reth 2000 bagëti . Pjesa tjetër që a kanë banorët dokumenta ose a paguajnë taksa që të kullosi kjo është punë tjeër. E para ju ftoj që të mos jepni dakortësinë sepse banorët që jetojnë në këto zona do të detyrohen të largohen. Tani unë do të sjell disa arsye ligjore :

Në parim me të vërtet ligji për konsultim public nuk e përcakton që mendimet e banorëve të merren parasysh. Është problem i madh i ligjit shqiptar. Por nga an tjetër është e moralshme që ju këshilltarë të merni në konsideratë mendimin e ketyre banorëve në momentin që votoni sepse e bën me legjitim këtë këshill Bashkiak. Tani unë do ti referohem udhëzimit nr1. Dr 09.06.2016 l cili dhe në relacionin e dorëzuar nga administrata e Bashkisë Pogradec e thotë qartazi që duhet paraprakisht në relacionin e Bashkisë të detajohet fondi kullosor dhe të shoqërohet me një relacion të plotë për mundësinë e ndryshimit të funksionimit të tij. Relacioni që ka ardh nga administrata ka ardhur vetem me një kërkesë nga individët që është qartazi në kundërshtim me ligjin për fondin kullosor pra e përcakton që duhet Bashkia te shprehe interesin dhe jo individi. Në pikën 3 të këtij udhëzimi përcaktohet që mund të jepet për përdorim vetëm për veprimtari të parashikuara në legjislacionin për pyjet dhe kullotat. Unë do ju sygjeroja të mos e miratoni sepse ne do e ngrejmë si process gjyqesor sepse ka pengesa ligjore.



D.Babasuli: Unë e nis fjalinë që në fillim që kanë dashur ta mernin me 1 Euro nga Vendimi I Këshillit të Investimeve Strategjike dhe nuk I pengonte askush. Bashkia I kundërshtoi duke mbrojtur interesat e banorëve. Përsa I përket ligjshmërisë nuk do ta fusim moralin në mes sepse ligjerisht ne jemi të pastër dhe moralisht është tjetër gjë. Përkatësisht do të thoja që e kam dhe moralin e pastër sepse po maximizojmë fitimin, të punësojmë minimumi 10 veta. Dhe nga ana ligjore jemi shumë të saktë sepse ato që përmendet ju z.avokat paraqiten në momentin e hedhjes në ankand .

Kejvi Mucllari (Banor) : Zotëria përmendi që është tokë zhargonisht, ky zotëria tjetër përmendi që nuk përdoret ka 35 vjet gjë që nuk është e vërtet. Ne e kemi shprehur dëshirën për ta marre me qera por nuk na ka adresuar asnjë njeri për procedurat që duhet të ndiqnim. Ajo është tokë fushë që përdoret nga blegtorët dhe ka reth 30-40 familje që e përdorin.

A.Gjoshe: Ju jeni banorë të zonës . Nqs keni projekte konkrete aplikoni.

Mentor Rama: Unë kam dy tre pyetje me shumë për avokatin. Unë di që sot jemi duke u përballur me një mentalitet që e kemi trashëguar prej 30 e ca viteve. Nuk jam vetëm në mbështetje të kolegëve të mi këshilltarë por t lutem mund të më thoni ka një shtet në Bashkimin Europian që I zapton tokat me dhunë pa asnjë pagesë ose një kontratë. Ne jemi në përpjekje për të qënë pjesë e Bashkimit Europian dhe ju si jurist jeni duke e njollosur shtetin tim duke mbështetur mentalitetin 30 vjecar që spo na le të ecim përpara. Zotëri jemi këtu për të hequr dorë nga ky mentalitet dhe të bëjmë më të mirën për qytetin tonë. Unë nuk mundem të mbështes mendimin tuaj I cili bije ndesh me mentalitetin e zaptimit . Une dua ligjin , të mbështes ligjin .

N.Torra (Specialsit I Bashkisë): Debati mund të jetë shumë I drejtë nga të dy palët por unë vij në cilësinë e specialistit të Bashkisë dhe vij me një dokument pronësie përpara e cila tregon se të drejtën e vendimarrjes e ka Këshilli I Bashkisë.Ne jemi të gatshëm tju japim informacion akoma më shumë nqs ju nk e keni kuptuar plotësisht.

M. Olldashi: Atëherë duke parë që të dy projekt –vendimet kanë nevojë për më shumë kohë dhe ti lemë kohë banorëve që të sqarohen dhe të aplikojnë për të marrë



tokat me qera , ftoj këshilltarët ti hedhim në votim për shtyrje të dy projekt vendimet.

Hedhim ne votim për shtyrje projekt-vendimin: Miratimin në parim të dhënies me qira, në favor të individëve kërkues për ndërtim fotovoltaikë(stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj), të pasurisë me sipërfaqe totale 303259 m2 (treqind e tremijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntëmijë) m2.

U votua

Pro 19

Kundër 1 (K.Gjona)

Abstenim 1(A.Male)

Miratohet për shtyrje Po



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 28.08. 2025

11.Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 35.5200 ha, të ndodhura në Njësinë Administrative Cërravë që mund të jepen me qera.

Diskutime:

M.Olldashi: Është e njëjta gje e hedhim në votim për shtyrje.

U votua

Pro 19

Kundër 1 (K.Gjona)

Abstenim 1(A.Male)

Miratohet për shtyrje Po

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Jef B'.

12. PROJEKT- VENDIM SHITES:

-Për miratimin e Planit të Integritetit për Bashkinë Pogradec.

Miranda Olldashi: Dhe Plan i Integritetit ka kaluar në Konsultim Publik, për një shpjegim më të detajuar ftojme specialisten Loredela Beqari e cila ka qënë te grupi i punës .

L. Beqari: Plan i Integritetit paraqet një mjet apo mekanizëm të rëndësishëm për forcimin e integritetit institucional. Ai është një dokument strategjik dhe operacional, që është produkt i procesit të vlerësimit të riskut të integritetit. Plan i Integritetit 2025–2028, vijon dhe përmirëson përvojën e akumuluar nga Plan i parë i Integritetit 2022–2025, i cili ishte iniciativa e parë e bashkisë për menaxhimin e riskut të integritetit në nivel vendor.

Qëllimi i këtij plani është të krijojë dhe konsolidojë një administratë vendore që i kundërvihet korrupsionit, transparente, inovative dhe e përgjegjshme për qytetarët, ku Këshilli Bashkiak (KB), administrata dhe shoqëria civile bashkëqeverisin në mënyrë etike dhe të krijojmë një administratë vendore që i kundërvihet korrupsionit.

Vlerësimi u zhvillua nga grupi i punës i ngritur me urdhrin Nr. 413, datë 22.07.2025 të Kryetarit të Bashkisë, ku bënë pjesë përfaqësues të administratës së institucionit, të cilët u asistuan nga ekipi i punonjësve dhe ekspertëve të AMVV, gjatë periudhës Korrik- Gusht 2025.

Miranda Olldashi: E hedhim në votim pikën 12 të rendit të ditës.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po **JO**



M.Oldashi: Gjithashtu në axhendë për këtë mbledhje kishim dhe raportim nga dy drejtori, përkatësisht nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit e cila do të raportojë muajin tjetër dhe nga Ndaermarrja e mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike.

Pa humbur kohë ja japim fjalën specialistit të Ndërmarrjes të flaës për masat e marra dhe punën e kryer për fillimin e vitit.

Joni: Masat janë marra të gjitha sic ishin planifikuar për fillimin e vitit të ri shkollor.

M. Oldashi: Du ate flas dhe unë pak për këtë pjesë. Përsa I përket shkollës 14 Ëngjëjt që unë drejtoj dua tju falenderoj për punën e kryer për fillimin e vitit të Ri Shkollor por dua tju lutem për pjesën e dizinfektimit të cilën na I kërkon inspektoriati dhe në momentin që kryhet duhet të pajisemi me një certifikatë.

Joni: Dizinfektimi këtë vit nuk do të realizohet nga Bashkia por nga një firmë pastrami e cila është hedhur në prokurim.

A.Prifti: Unë insistoј tek koshat e mbeturinave që janë ngjitur me oborrin e shkollës Esat Minarolli. Duhet pastruar minimum ose të ndrohen sepse janë të amortizuar.

M.Oldashi: Mbledhjen e deklaroј të mbyllur.

Protokollor:
Sekretare e Këshillit
Jona Bajko

